

PROCESVERBAL
nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 19.11.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: Dr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Magdalena Dovleva Davidovska, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit Petrushevski hapi seancën e 43-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro" (anëtarja e Këshillit Alma Mashoviq nuk ishte e pranishme në momentin e votimit), miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.10.2024.
2. Draft - planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2025.
3. Draft - planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2025.
4. Draft - programi i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 (me Draft - programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Draft - Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025).
5. Propozim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik - shërbim: Lidhje interneti me hostim të internet sajteve.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 4 vota "pro" dhe një abstenim nga anëtari i Këshillit, Llazar Trajçev (anëtarja e Këshillit, Alma Mashoviq nuk ishte e pranishme në momentin e

votimit), miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 42-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.10.2024, me tekstin e propozuar.

Pikat 2, 3 dhe 4

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski propozoi që Pikat 2, 3 dhe 4 të shpjegohen me një hyrje dhe diskutim të përbashkët, pasi që përfaqësojnë një tërësi, dhe më pas secila prej tyre të votohet individualisht.

Drejtori Zoran Trajçevski prezantoi Draft - planet për mbikëqyrje programore dhe administrative për vitin 2025. Në mbikëqyrjen e programit përfshihen tre grupe subjektesh: transmetuesit, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Mbikëqyrja administrative fokusohet në transmetuesit dhe botuesit e medias së shkruar. Theksohet se ndryshimet në Ligjin për Media, të cilat ende janë në diskutim publik, nëse miratohen do të integrohen në versionin përfundimtar të planeve. Programi i punës së Agjencisë përfshin aktivitetet e planifikuara dhe planin financiar për vitin 2025. Prioritetet kryesore përfshijnë monitorimin e mbulimit mediatik të zgjedhjeve lokale në gjysmën e dytë të vitit, mbikëqyrjen e rregullt të subjekteve mediatike dhe organizimin e eventeve për arsimimin mediatik. Gjithashtu, do të monitorohen strukturat e pronësisë së televizioneve dhe radiove për të parandaluar përqendrimet e paligjshme mediatike. Një nga projektet kyçe për vitin 2025 është iniciativa për krijimin e fondit për mbështetjen e pluralizmit mediatik, i cili është subjekt i angazhimeve afatgjate të Agjencisë. Gjithashtu do të përpilohen disa analiza dhe studime, duke përfshirë hulumtimin mbi lehtësimin tatimor për mediat rajonale, lokale dhe jofitimprurëse, analizën e ndikimit të inteligjencës artificiale, teknologjitë e reja në media dhe analizën gjinore në programet mediatike. Në nivel ndërkombëtar, Agjencia do të vazhdojë të marrë pjesë në aktivitetet e organizatave ku është anëtare, si dhe bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, OSBE-në dhe Këshillin e Evropës.

Drejtori Zoran Trajçevski prezantoi detaje nga plani financiar i Agjencisë për vitin 2025. Në kuadër të Draft-planit financiar, të ardhurat për vitin 2025 llogariten në 198.275.722 denarë, një pjesë e konsiderueshme e të cilave vijnë nga buxheti i shtetit dhe mjetet e akumuluar nga vitet paraprake. Konkretisht, 78 milionë denarë janë nga mjetet buxhetore, ndërsa të ardhura shtesë do të realizohen përmes kompensimeve për leje dhe shërbime, si dhe nga financimi i aktiviteteve lidhur me zgjedhjet lokale. Nga ana e shpenzimeve, pika më e lartë janë pagat e të punësuarve (107.309.722 denarë), ku përfshihen dhe punësime të reja, si dhe shpenzimet për shërbime nga jashtë për monitorim gjatë zgjedhjeve. Shpenzime të tjera të rëndësishme përfshijnë blerja dhe dhënia me qira e pajisjeve (gjithsej mbi 12 milionë denarë), konsumi i energjisë elektrike (10.400.000 denarë), dhe investimet në softuer për analizë automatike të përmbajtjeve mediatike, bazuar në inteligjencën artificiale (3.260.000 denarë). Planin financiar për vitin 2025 është më i lartë për 18% krahasuar me një vit më parë, çka tregon nevojën të shtuarë për kryerjen e detyrimeve programore dhe administrative të Agjencisë.

Anëtari i Këshillit Zoran Fidanoski shprehu mbështetjen për Draft - versionin e planeve vjetore dhe programit të punës. Ai vlerësoi përgatitjen e detajuar të dokumenteve, duke theksuar se ato mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme për realizimin me sukses të detyrave në vitin 2025. Sipas tij, përbërja e re e Këshillit do të sjellë rritje të kostove, por pret që të ardhurat e Agjencisë të rriten falë pagesës së parashikuar të kompensimeve. Ai veçanërisht thekson rëndësinë e analizave të shpallura, si ato për tregun mediatik dhe kompensimet

lehtësuese për mediat rajonale, lokale dhe jofitimprurëse. Ai beson se këto hulumtime do të kontribuojnë në forcimin e pluralizmit mediatik dhe demokracisë. Ai gjithashtu thekson se integrimi i inteligjencës artificiale është hap kyç përpara për mediat, duke shtuar se përdorimi i teknologjive të reja duhet të synojë ndaj përfitimit social. Nisma për krijimin e fondit për mbështetjen e pluralizmit mediatik është theksuar si një nga prioritetet më të rëndësishme. Sipas Fidanoskit, një fond i tillë mund të mbështesë gazetarinë hulumtuese dhe mediat me kapacitet më të dobët ekonomik. Ai gjithashtu propozon, krahas aktiviteteve të planifikuara, të sigurohen ndryshime në ligjet përkatëse, veçanërisht në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për përmirësimin e kornizës rregullative. Ai propozoi një analizë të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale për rikonstruim të plotë dhe të mundshëm. Sipas tij, Ligji bazohet mbi standarde të vjetra që nuk korrespondojnë me mjedisin e sotëm digjital dhe rregullator. Në këtë drejtim, ai theksoi se duhet të rishikohen edhe rregulloret e reja evropiane, si akti për shërbimet digjitale dhe Akti evropian për lirinë e mediave, si dhe ndikimi i tyre mbi legjislacionin e Maqedonisë për media. Ai theksoi në veçanti çështjen e përqendrimit mediatik, duke konsideruar se normat aktuale janë të vjetruara.

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski bëri thirrje për vëmendje ndaj Ligjit për Media, me theks në përfshirjen e portaleve online si media. Ai theksoi se është e rëndësishme të merret parasysh Kodi zgjedhor në ndryshimet e propozuara për të shmangur mospërputhjet e mundshme ligjore, veçanërisht për sa i përket financimit dhe të drejtës për regjistrimin e mediave. Petrushevski, po ashtu përmendi edhe kufizimet financiare me të cilat ballafaqohet Agjencia, theksoi se në vitet e kaluara Agjencia në mënyrë të konsiderueshme ka ndihmuar financiarisht mediat, por rezervat aktuale janë të kufizuara, duke theksuar se duhet t'i kushtohet vëmendje shpenzimeve në periudhën e ardhshme.

Zëvendës kryetari, Selver Ajdini u pajtua me Draft - dokumentet e propozuara, duke theksuar rëndësinë e investimeve kapitale për furnizimin e softuerit për dedektimin automatik të reklamave dhe gjuhës së urretjes, bazuar në inteligjencën artificiale. Ai beson se kjo teknologji është veçanërisht e rëndësishme për sektorin programor dhe se do të mundësojë dedektimin më të shpejtë të përmbajtjeve të padëshiruara në media. Edhe Ajdini ka shprehur mbështetjen e tij për tre Draft dokumentet, duke vlerësuar se ato janë përgatitur në mënyrë profesionale.

Anëtari i Këshillit, Zoran Fidanoski, theksoi rëndësinë e blerjes së softuerit të ri për dedektimin automatik të reklamave dhe gjuhës së urretjes bazuar në inteligjencën artificiale. Ky softuer, i cili tashmë përdoret në vendet evropiane, mund të rrisë ndjeshëm efikasitetin e Agjencisë. Si shembull, Fidanoski shpjegoi se softueri mund të zvogëlojë kohën e përgatitjes së analizave nga disa javë në vetëm disa ditë, duke mundësuar kryerjen më të shpejtë dhe më efikas të detyrave. Ai inkurajoi Agjencinë që të integrojë këtë softuer, duke theksuar përfitimet e tij të mundshme.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft - planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore në vitin 2025, me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Draft - planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore në vitin 2025 të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-planin vjetor të lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të ofrohet diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft - planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2025, me tekstin e propozuar.

Agjencia, në lidhje me Draft - planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2025, të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft – planin vjetor ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të ofron diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft - programin e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 (me Draft - Programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Draft - planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025) me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Draft -programin e lartpërmendur, të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-programin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të ofron diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, prezantoi rrjedhën dhe rezultatet e procedurës për furnizim publik lidhje interneti me hostim të internet sajteve të Agjencisë. Ajo shpjegoi se procesi ka përfunduar me kohë me dy oferta nga operatorë ekonomikë. Në procedurën e tenderit kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomikë: Neotel dhe Gou-net. Megjithëse u organizua ankand elektronik, asnjë ofrues nuk e rishikoi ofertën e tij fillestare. Oferta më e ulët, nga operatori Neotel, ishte 420.000 denarë pa TVSH, që e tejkalon shumën e parashikuar për këtë blerje për 60.000 denarë. Mitrevska ka shpjeguar se sipas Ligjit për furnizim publik oferta është e pranueshme sepse çmimi është në pajtim me kushtet reale të tregut dhe është më ekonomik sa i përket përsëritjes së procedurës. Ajo propozoi ndryshimin e Vendimit për furnizim publik duke rritur shumën e parashikuar të 420.000 denarë pa TVSH. Ajo shtoi se mjetet shtesë tashmë janë të parapara në planin financiar të Agjencisë, kështu që nuk është i nevojshëm ndryshim të Planit vjetor për furnizim publik.

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski e përkrahu vendimin, duke theksuar se rritja e çmimit është e arsyeshme, duke pasur parasysh rritjen e përgjithshme të shpenzimeve të energjisë dhe pagave.

Po ashtu, drejtori Zoran Trajçevski theksoi se kontrata është për tre vjet, që do të thotë se kostoja shtesë prej 60.000 denarë i referohet 20.000 denarë në vit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për dhënien shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik - shërbim: Lidhje interneti me hostim të internet sajteve, dhe rrjedhimisht ndryshimin e Vendimit për nevojën e furnizimit publik nr. 05-3757/1 datë 13.09.2024.

Shuma e përgjithshme e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës së furnizimit publik do të jetë 420.000,00 denarë pa TVSH , ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele për vitin 2024, gjegjësisht do të parashikohen në Planet financiare të Agjencisë për vitet 2025, 2026 dhe 2027.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**